



Operatori i Sistemit të Transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.
më ____ . ____ .2019

Tiranë,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)
Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9
Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: **OE: “PASTRIME SILVIO” sh.p.k., me NIPT K91413010N**
Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2,
Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” - me mjete elektronike – Shërbime

Numri i referencës i procedurës: REF-31187-07-23-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i pastrimit dhe gjelbërimit për godinën qendrore të OST sh.a.”

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 29.07.2019, Nr. 30

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët

Fondi Limit: 16,920,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet mijë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 26.08.2019

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 (katër) ofertues, me vlerë përkatëse të ofruar:

- BOE “Clean Fast” sh.p.k.** me NIPT L61807037R
“Hastoçi” sh.p.k. me NIPT J62028009B

me ofertë ekonomike 12,859,200 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë

mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.

2. OE “Shpresa” sh.p.k. me NIPT K67917301H

me ofertë ekonomike 15,043,560 (pesëmbëdhjetë milion e dyzet e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

3. OE “Silvio Pastrime” sh.p.k. me NIPT K91413010N

me ofertë ekonomike 16,516,262.4 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy presje katër) Lekë pa TVSH.

4. OE “Fusha” sh.p.k. me NIPT J61922018S

me ofertë ekonomike 16,863,992.4 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy presje katër) Lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “Shpresa” sh.p.k., me NIPT K67917301H

për arsye se:

o Nuk ka përmbushur pikën 3.3.19, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ofertues, ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga një moster për artikujt që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit.....” sepse:*

i) OE Shpresa ka paraqitur mostrat në Orën 10:58 të datës 26/08/2019 (pasqyruar dhe në procesverbalin e datës 26.08.2019) ku ndërkohe afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, me anë të shtojcës për modifikim në dokumentet e tenderit të datës 13.08.2019, është përcaktuar **data: 26/08/2019, Ora: 10:00.**

ii) Megjithatë mungon njëri prej produkteve të listuar në DST pika 3.3.19 tabela konkretisht produkti Nr.7 i tabelës **Fshesa për fshirje në të thatë.**

o Nuk ka përmbushur pikën 3.3.12, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit **citojmë:** *“Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera një vinç, në lartësi jo më pak se 30 metra për larjen e fasadës së jashtme të godinës me kosh të montuar në krahun e tij (e paçmontueshme) sipas specifikimeve teknike (shtojca 9)”* sepse në të gjithë dokumentacionin e paraqitur në përmbushje të këtij kriteri nuk është specifikuar lartësia e vinçit.

2. BOE “Clean Fast” sh.p.k. me NIPT L61807037R

“Hastoçi” sh.p.k. me NIPT J62028009B

për arsye se:

o Nuk ka përmbushur pikën 3.3.8, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse:

i. OE “HASTOÇI“ sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik nuk disponon Licencën II.4 për prodhimin dhe tregtimin e farave dhe fidanëve për shërbimin e gjelbërimit. Në marrëveshjen e bashkëpunimit me Nr.3232Rep. dhe Nr.878Kol. datë 22.08.2019 të lidhur ndërmjet **Clean Fast & Hastoçi** në nenin 5 të saj parashikohet ndarja e punimeve dhe detyrat e secilës palë, Hastoçi ka marrë përsipër Shërbimin e Gjelbërimit për të cilin nevojitet licenca

e sipërcituar. Kjo në kundërshtim me V.K.M. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 74 pika 3 ku parashikon se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*”

ii. OE “Clean Fast“ sh.p.k. pjesë e bashkimit të OE, nuk disponon Licenca për punime të Inxhinierisë së Mjedisit me Kod NP-12 A të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transporteve. Referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit me Nr.3232Rep. dhe Nr.878Kol. datë 22.08.2019 të lidhur ndërmjet BOE në nenin 5 pika ABCD parashikohen detyrat e Clean Fast, dhe konkretisht ky i fundit ka marrë përsipër të kryejë pastrime për të cilat nevojitet domosdoshmërisht kjo licencë. Mospasja e kësaj licence bie dhe në kundërshtim me V.K.M. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 74 pika 3.

o Në lidhje me mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi të përcaktuar në shtojcën 12 Termat e referencës së dokumentave të tenderit, bashkimi i operatorve ekonomik nuk disponon “*Platformë ajrore/ngritëse*” për përdorimin në ambientet e brendshme për punimet dhe ngritje në lartësi e cila duhet të jetë me lartësi mbi 8 m, sepse në dokumentacionin e sjellë figuron një makinë platformë për përdorim të jashtëm.

3. OE “Fusha” sh.p.k. me NIPT J61922018S

për arsye se:

o Nuk ka përmbushur pikën 3.3.14 “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera të gjitha makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit si:*

- *Mjete thithëse pluhurash dhe lëngjesh.*
- *Mjete larje-tharje.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë faturat tatimore të blerjes / fletën e zhdoganimit ose kontratën e qirasë, si dhe specifikimet teknike (skeda teknike) të këtyre mjeteve. OE nuk ka paraqitur skedën teknike dhe as specifikimet në lidhje me këto makineri.

- Nuk ka përmbushur pikën 3.3.16 “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse: *Detergjentët e kërkuar për kryerjen e shërbimit të pastrimit duhet të jenë të një cilësie të lartë, kjo për shkak të vetë cilësisë së lartë të ambienteve të brendshme të OST Sh.a. Ato duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara në DT. Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë specifikimet teknike të perkthyerat dhe të noterizuara të tyre.*

Detergjentët duhet të jenë të një marke të njohur, dhe kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e faturave Pro Forma të blerjes së këtyre detergjentëve nga firmat prodhuese.

OE nuk ka paraqitur asnjë faturë për blerjen e detergjentëve.

- Nuk ka përmbushur pikën 3.3.12 “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit sepse: „*Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera një vinc, në lartësi jo më pak se 30 metra për larjen e fasadës së jashtme të godinës me kosh....*”. Në dokumentacionin e sjellë nga OE nuk është e specifikuar lartësia e vinçit pasi për këtë nuk ka paraqitur asnjë dokument. Gjithashtu nga fotot vihet re se koshi është i çmontueshëm ndryshe nga kërkesat e

DT.

○ Në lidhje me mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi t përcaktuar në shtojcën 12 Termat e referencës së dokumentave të tenderit, bashkimi i operatorve ekonomik nuk disponon “*Platformë ajrore/ngritëse*” për përdorimin në ambientet e brendshme për punimet dhe ngritje në lartësi e cila duhet të jetë me lartësi mbi 8 m, sepse në dokumentacionin e sjellë figuron një makinë platformë për përdorim të jashtëm.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “PASTRIME SILVIO” sh.p.k.**, me **NIPT K91413010N**, Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë, për vlerën **16,516,262.4 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë katër) Lekë pa TVSH**, se është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km. 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.09.2019.

Ankesa: Po.

- Përgjigje në datë 19.09.2019.
- Përgjigje në datë 20.09.2019.

KPP: Po.

- Vendim i KPP-së Nr. 709, datë 12.11.2019.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova